



BASHKIA
TIRANË
KRYETARI

Nr. prot. 14860

Tiranë më 6/5 2016

Drejtuar: **Z. Aldrin Dalipi**
Kryetar
Këshilli Bashkiak i Tiranës

Lënda: **Dërgohet projekt - vendim dhe relacion për shqyrtim dhe miratim**

I nderuar z. Dalipi,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim projekt vendimin dhe relacionin për “Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të njësive administrative të Tiranës”.

Ju urojmë punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR



Erion Veliaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

VENDIM (projekt)

Nr. _____, datë _____ 2016

për

“Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të njësive administrative të Tiranës”

Në mbështetje nenit 8 pika 2 dhe nenit 54 shkronja “ç”, nenin 55, pika 2, nenin 69, pika 3, nenin 71, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; Ligjin nr. 115/ 2014 për “Ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 5, shkronjat “a” dhe “d” të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165, datë 02.03.2016 për “Grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”; he vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016” me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Njësive Administrative me 20 001 – 50 000 banorë, sipas lidhjes nr.1 bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Njësive Administrative me 50 001 – 100 000 banorë, sipas lidhjes nr.2 bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Njësive Administrative me 5 001 – 20 000 banorë, sipas lidhjes nr.3 bashkëngjitur këtij vendimi.
4. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Njësive Administrative me më pak se 5 000 banorë, sipas lidhjes nr.4 bashkëngjitur këtij vendimi.
5. Të miratojë shpërblimin mujor të 144, kryetarëve të fshatrave në masën 5 000 lekë.
6. Të miratojë shpërblimin mujor të 214, ndërlidhësave komunitare në masën 5000 lekë.

7. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Maj të vitit 2016 dhe do të përballohen nga buxheti i Aparatit të Bashkisë për vitin 2016.
8. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Financës.
9. VKB nr.27, datë 13.08.2015 për “Disa ndryshime në nivelin e pagave të punonjësve të Njësive Administrative të Tiranës revokohet.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Aldrin Dalipi

Lidhja Nr. 1 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me 20 001 – 50 000 banorë

EMËRTIMI	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Administrator	—	—	—	—	92 500
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	42 000
Përgjegjës Zyre, Specialist	III	b	1ose 2	2%	40 000
Specialist	IV	a	1ose2ose3	2%	34 000
Specialist	IV	b	1ose2ose3	2%	28 000

Lidhja Nr. 2 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me mbi 50 000 banorë

EMËRTIMI	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Administrator	—	—	—	—	100 000
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	45 000
Përgjegjës Zyre, Specialist	III	b	1ose 2	2%	42 000
Specialist	IV	a	1ose2ose3	2%	34 000
Specialist	IV	b	1ose2ose3	2%	28 000

Lidhja Nr. 3 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me 5 001 - 20 000 banorë

EMËRTIMI	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Administrator	—	—	—	—	79 500
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	35 000
Përgjegjës Zyre, Specialist	III	b	1ose 2	2%	32 000
Specialist	IV	a	1ose2ose3	2%	30 000
Specialist	IV	b	1ose2ose3	2%	25 000

Lidhja Nr. 4 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me më pak se 5 000 banorë

EMËRTIMI	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Administrator	—	—	—	—	56 100
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	31 000
Përgjegjës Zyre, Specialist	III	b	1ose 2	2%	29 000
Specialist	IV	a	1ose2ose3	2%	27 000
Specialist	IV	b	1ose2ose3	2%	25 000

Lidhja nr. 5 – Niveli i pagës për punonjësit administrativ të Njësive Administrative

Nr	Emërtimi	Klasa	Paga Bazë	Shtesa për vjetërsi ne %
1	Specialist me arsim te mesëm, Topograf	VI	32 000	1%
2	Arkivist-protokollist	V	30 000	1%
3	Punonjës shërbimi, Magazinier	IV	28 000	1%
4	Shofer	III	27 000	1%
5	Punetor shërbimi, mirëmbajtës	II	26 000	1%
6	Pastruese, Roje	I	25 000	1%

Shtesa për vjetërsi në punë **për Lidhjen nr. 5** të jepet **në masën 1%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet mbi **pagën baze të klasës së I.**



BASHKIA
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MENAXHIMIT FINANCIAR

RELACION

për

“Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të njësive administrative të Tiranës”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 dhe nenit 54 pika ç të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit nr.152/2013 “ Për nëpunësin civil” (i ndryshuar); ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë; ligjit nr.10405, datë 24.03.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” (i ndryshuar), vendimit të Këshillit të Ministrave nr.169, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr.27, datë 13.08.2015 për “Disa ndryshime në nivelin e pagave të Njësive Administrative të Tiranës” ; vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016” , propozojmë përpara jush për miratim lidhjet e pagave për punonjësit e Njësive Administrative, si më poshtë:

Me zbatimin e Reformës Territoriale, Bashkia e Tiranës ka në varësi 24 Njësi Administrative të përbëra nga 13 ish- Komuna si dhe 11 Njësitë Bashkiake të cilat funksionojnë brenda Aparatit të Bashkisë. Për efekt të kategorizimit të pagave, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave, **nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”** Njësitë Administrative janë grupuar në bazë të numrit të banorëve në territoret ku ato kryejnë funksionet. Në përshtatje të Vendimit të Këshillit të Ministrave, paraqesim për miratim Lidhjet e pagave grupuar sipas numrit të banorëve si më poshtë vijon:

Në Lidhjen nr.1 përcaktohet paga e grupit, vjetërsia dhe shtesa për pozicion për punonjësit e Njësive Administrative të Tiranës me 20 001- 50 000 banorë, bazuar në kategoritë e përcaktura në Lidhjen nr.1 të Vendimit e Këshillit të Ministrave nr.169, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Kjo lidhje përfshin Njësitë Administrative nr.3,8,10 si dhe Kashari.

Lidhja Nr. 1 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me 20 001 – 50 000 banorë

EMËRTIMI	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Administrator	—	—	—	—	92 500
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	42 000
Përgjegjës Zyre, Specialist	III	b	1ose 2	2%	40 000
Specialist	IV	a	1ose2ose3	2%	34 000
Specialist	IV	b	1ose2ose3	2%	28 000

Në Lidhjen nr.2 përcaktohet paga e grupit, vjetërsia dhe shtesa për pozicion për punonjësit e Njësive Administrative me 50 001- 100 000 banorë, bazuar në kategoritë e përcaktuara në Lidhjen nr.1 të Vendimit e Këshillit të Ministrave nr.169, datë 02.03.2016. Kjo lidhje përfshin Njësitë Administrative nr.1,2,4,5,6,7,9,11

Lidhja nr. 2 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me mbi 50 000 banorë

EMËRTIMI	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Administrator	—	—	—	—	100 000
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	45 000
Përgjegjës Zyre, Specialist	III	b	1ose 2	2%	42 000
Specialist	IV	a	1ose2ose3	2%	34 000
Specialist	IV	b	1ose2ose3	2%	28 000

Në Lidhjen nr.3 përcaktohet paga e grupit, vjetërsia dhe shtesa për pozicion për punonjësit e Njësive Administrative të Tiranës me 5 001- 20 000 banorë, bazuar në kategoritë e përcaktuara në Lidhjen nr.1 të Vendimit e Këshillit të Ministrave nr.169, datë 02.03.2016
Kjo lidhje përfshin Njësitë Administrative Bërzhitë, Baldushk, Dajt, Farkë, Ndroq, Petrelë, Pezë, Vaqarr, Zall-Herr, Zall-Bastar.

Lidhja Nr. 3 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me 5 001 - 20 000 banorë

EMËRTIMI	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Administrator	—	—	—	—	79 500
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	35 000

Përgjegjës Zyre, Specialist	III	b	1ose 2	2%	32 000
Specialist	IV	a	1ose2ose3	2%	30 000
Specialist	IV	b	1ose2ose3	2%	25 000

Në Lidhjen nr.4 përcaktohet paga e grupit, vjetërsia dhe shtesa për pozicion për punonjësit e Njësive Administrative të Tiranës me më pak se 5 000 banorë, bazuar në kategoritë e përcaktuara në Lidhjen nr.1 të Vendimit e Këshillit të Ministrave nr.169, datë 02.03.2016. Kjo lidhje përfshin Njësitë Administrative Krrabë, Shëngjergji.

Lidhja Nr. 4 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me më pak se 5 000 banorë

EMËRTIMI	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Administrator	—	—	—	—	56 100
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	31 000
Përgjegjës Zyre, Specialist	III	b	1ose 2	2%	29 000
Specialist	IV	a	1ose2ose3	2%	27 000
Specialist	IV	b	1ose2ose3	2%	25 000

Në Lidhjen nr.5 përcaktohet paga bazë dhe shtesa për vjetërsi 1% mbi pagën bazë të klasës së I për punonjësit administrativ në 24 Njësitë Administrative, bazuar në pikat 19,20 të Vendimit e Këshillit të Ministrave nr.169, datë 02.03.2016

Lidhja nr. 5 – Niveli i pagës për punonjësit administrativ të Njësive Administrative

Nr	Emërtimi	Klasa	Paga Bazë	Shtesa për vjetërsi ne %
1	Specialist me arsim te mesëm, Topograf	VI	32 000	1%
2	Arkivist-protokollist	V	30 000	1%
3	Punonjës shërbimi, Magaznier	IV	28 000	1%
4	Shofer	III	27 000	1%
5	Punetor shërbimi, mirëmbajtës	II	26 000	1%
6	Pastruese, Roje	I	25 000	1%

Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen nr. 5 jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën baze të klasës së I.

Aplikimi i pagës sipas lidhjeve të mësipërme do të fillojë nga data 1 Maj 2016 dhe efektet financiare të rritjes së pagave do të përballohen nga buxheti i Aparatit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë sa kemi parashtruar në këtë relacion, ju paqesim për miratim nivelin e pagave për punonjësit e njësive administrative të Tiranës.

Duke shprehur në miratimin e këtij projekt-vendimi nga ana juaj,

Drilona Aliko
Specialist i Sektorit të Asisitencës Ligjore dhe Legjislacionit

Arba Isaj
Përgjegjës i Sektorit të Zbatimit të Buxhetit

Anisa Seferaj
Drejtori i Drejtorisë Juridike

Jonida Halili
Drejtor i Përgjithshëm i Menaxhimit Financiar

Itena Ndroqi
Drejtor i Përgjithshëm Juridik i Aseteve dhe Licensimit

Keti Luarasi
Drejtor i Përgjithshëm i Burimeve Njerëzore

Arbjan Mazniku
Zv. Kryetar

Arsela Gjonaj
Juriste e Këshillit Bashkiak

Behar Zeneli
Sekretar i Këshillit Bashkiak